**KONTRATË**

**PËR SHITBLERJEN E KUOTAVE**

Sot, më datë 01.11.2018, palët e kësaj Kontrate Shitblerje Kuotash me termat e mëposhtme :

SHITËSAT : **1.Albert Matoshi** i biri i Gjeloshit , i datëlindjes 30.05.1985, lindur në Dardhe Puke perfaqesuar me prokure te posacme Nr 2833 Repertori dt 05.10.2018, redaktuar para noterit Alberto Colomno me seli ne Mariano Comense nga Pranvera Matoshi e bija e Markut , e dtl 29.04.1987, lindur ne Dardhe Puke dhe banuese ne Kamez Tirane, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, me dokument identifikues leternjoftim Id.Nr I75429095J.

**2.Violeta Doda,** e bija e Dod-es e dtl 04.06.1976, lindur ne Gjader Lezhe perfaqesuar me prokure te posacme Nr 2833 Repertori dt 05.10.2018 redaktuar para noterit Alberto Colomno me seli ne Mariano Comense nga Pranvera Matoshi e bija e Markut , e dtl 29.04.1987, lindur ne Dardhe Puke dhe banuese ne Kamez Tirane, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, me dokument identifikues leternjoftim Id.Nr I75429095J.

**Flavio Mirko Cappelletti** i biri i Ettore-s i dtl 09.07.1970, lindur ne Milano dhe banues ne Via Spaino 15 Mariano Comense Itali, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, me dokument identifikues karte identiteti italiane Nr AX2245131.

**BLERËSI :** **Pranvera Matoshi** e bija e Markut , e dtl 29.04.1987, lindur ne Dardhe Puke dhe banuese ne Kamez Tirane, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, me dokument identifikues leternjoftim Id.Nr I75429095J.

Të cilët hartuan e këtë kontrate për shitblerjen e kuotave të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar, si më poshtë vijon:

*DUKE QENË SE EKZISTOJNË KËTO KUSHTE PARAPRAKE:*

Shoqëria tregtare "CONSUTEK " SH.P.K. është regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit me Nr NIPT L41817014E dt 17.06.2014 dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e saj të themelimit. Shoqëria ka kapital themeltar të regjistruar prej 100.000 (njëqindmijë) Lekë, të zotëruar nga ortakët e shoqërisë me këtë shpërndarje: Z. Pranvera MATOSHI zotëron 70% të kuotave, Z. Flavio Mirko CAPEPELLETTI zotëron 20% të kuotave, Z. Albert Matoshi zoteron 5% te kuotave dhe Violeta Matoshi zoteron 5%te Kuotave, dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e saj të themelimit.

**NENI 1**

Pranvera Matoshi Pranvera Matoshi Pranvera Matoshi

**OBJEKTI**

Pala Blerëse, blen 20% të kapitalit të shoqërisë, me vlerë 20.000 lekë te ortakut Flavio Mirko Cappelletti, 5% , të kapitalit te shoqerise me vlere 5000 leke, te ortakut Albert Matoshi, 5% te kapitalit te shoqerise me vlere 5000 leke te ortakes Violeta Doda të shoqërisë tregtare "CONSUTEK " Sh.p.k. duke kaluar në pronësi të Palës Shitëse, dhe merr përsipër të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kalimi i pronësisë mbi to.

**NENI 2**

**KUSHTET**

Kuotat, objekt i kësaj kontrate, shiten prej Shitësave dhe blihen nga ana e Blerëses në gjendjen në të cilën rezultojnë aktualisht nga librat e shoqërisë. Pala Blerëse deklaron se është në dijeni të të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga kalimi i pronësisë së kuotave dhe se i pranon ato ne gjendjen ne të cilën ndodhen, pa patur asnjë pretendim në lidhje me to as sot as në të ardhmen.

**NENI 3**

**ÇMIMI**

Çmimi i ketij operacioni shitblerjeje të kuotave përcaktohet, me marrëveshjen e përbashkët të palëve, në shumën 30 000 leke , që korrespondon me vlerën nominale të kuotave.

**NENI 4**

**MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË KUOTAVE**

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Pala Shitëse humbet pronësinë mbi masën prej 30% të të kapitalit themeltar të Shoqërise "CONSUTEK " Sh.P.K, duke mos patur në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi këtë pjesë të kuotave të shoqërisë.

Në të njëjtin moment, Pala Blerëse bëhet pronare e 30% të kapitalit të zotëruara nga Pala Shitëse në kapitalin themeltar të shoqërisë "CONSUTEK " Sh.p.k., të cilat i bashkohen pjesëmarrjes ekzistuese të ortakut Blerës në kapitalin themeltar të kësaj shoqërie.

Pas realizimit të kësaj kontrate shitblerje, kuotat e shoqërisë "CONSUTEK " Sh.p.k. do të zotërohen në këtë mënyrë:

- Z **. Pranvera Matoshi** , në cilësinë e ortakes se vetëm të shoqërisë dhe administratores , zotëron 100% të kapitalit të shoqërisë.

**NENI 5**

**GARANCITË DHE DETYRIMET E PALËS SHITËSE**

Pala Shitëse garanton Palën Blerëse:

Pranvera Matoshi Pranvera Matoshi Pranvera Matoshi

a) kjo kontratë lidhet rregullisht nga ana e palës shitëse dhe përcakton lindjen e detyrimeve në ngarkim të saj, në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj kontrate.

b) pala shitëse e deklaron dhe e garanton palën blerëse se: A) ka pronësinë e plotë dhe të lirë të kuotave; B) se kuotat janë të gjitha të lira nga barra, pengje dhe të drejta apo pretendime të cdo lloji nga të tretë; C) se ka të gjitha të drejtat dhe kompetencat për të shitur, kaluar, transferuar kuotat në përputhje me kushtet e përmbajtura në këtë kontratë.

**NENI 6**

**TË NDRYSHME**

Për aq sa nuk është parashikuar në këtë kontratë do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë që i referohen kontratës së shitblerjes dhe për sa përputhen me objektin e kësaj kontrate.

**NENI 7**

**DISPOZITA TË FUNDIT**

Kjo kontratë hartohet në katër kopje të njëjta.

Termat e kontratës, pasi u redaktuan në gjuhën Shqipe dhe meqenese **Flavio Mirko Cappelletti** nuk flet dhe njeh gjuhen shqipe ky akt u perkthye ne prezence te perkthyesit Leonard Maçi i biri i Isuf-it, lindur ne Tirane me 13.04.1971, me banim ne Tirane, Rruga Petro N. Luarasi, Pallati 1, shk. 1, identifikuar prej meje me leternjoftim ID. Nr. Personal H10413057P, dhe u nënshkruan nga palët me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë.

**PALËT**

**SHITËSI T**
**ALBERT MATOSHI**
**perf me prokure**
Pranvera Matoshi

**BLERËSI**
**PRANVERA MATOSHI**
Pranvera Matoshi

**VIOLETA DODA**
perf me prokure
Pranvera Matoshi

**FLAVIO MIRKO CAPPELLETTI**

Consutek Sh.p.k.
Bulevardi Blu, pranë gjimnazit Ibrahim Rugova
1000 Kamez, Tirane
Nipt L41817014E

PERKTHYES I GJOE
TRADUTTORE LEGALE
LEONARD MAÇI